

Hapet thirrja për bursa në programin Erasmus + në Universitetin Ca'Foscari të Venecias në Itali për semestrin e dytë të vitit akademik 2020-2021.

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin Ca' Foscari të Venecias në Itali, në kuadër të programit Erasmus +, për studentët Master dhe Ph.D, për semestrin e dytë të vitit akademik 2020-2021.

<https://www.unive.it/pag/13526>

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve Master (vetëm për studentët e fushës Histori dhe Arkeologji);
- Shkëmbimin e studentëve Ph.D. (për studentët e fushave: Gjuhë Shqipe, Histori dhe Arkeologji);

Fushat e studimit:

- Gjuhë Shqipe;
- Histori dhe Arkeologji;

Katalogu i kurseve:

<https://www.unive.it/data/9639/>

Kohëzgjatja e bursave:

- Master / Doktoraturë (1 semestër);

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (850 EUR në muaj për studentët)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe / ose tarifën e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:

-CV (në gjuhën angleze/italiane sipas formatit Europass);

-Kopje e Pasaportës;

-Vërtetim studentit (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);

- Formulari i aplikimit, sipas linkut:

https://unitiredu-my.sharepoint.com/:w:/g/personal/iro_unitir_edu_al/ERrjn1nZmsBPvFm2UIHp-mMBNipVH_Wp50oiXq0_Lzhndg?e=D0ccHb

-Diplomë e nivelit Bachelor;

-Listë notash e nivelit Bachelor (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);

-Listë notash e nivelit Master (e përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze/italiane në varësi të programit të studimit;

-Certifikata e gjuhës së huaj, niveli B2 (Italisht/Anglisht);

-*Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë ‘Before mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin pritës lëndë të njëjta me ato që do të kryeni në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur

të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Nëse studenti kryen ndryshime “During mobility”, kjo pjesë e dokumentit duhet firmosur nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

https://unitiredu-my.sharepoint.com/:w:/g/personal/iro_unitir_edu_al/EVwAsTozr2lMu0UhE51dptMBXH3SeMnGTZ1uUtPJIbdxFw?e=Hq5qjK

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Ph.D.:

- CV + publikime (në gjuhën angleze/italiane sipas formatit Europass);

- Formulari i aplikimit, sipas linkut:

https://unitiredu-my.sharepoint.com/:w:/g/personal/iro_unitir_edu_al/ERrjn1nZmsBPvFm2UIHp-mMBNipVH_Wp50oiXq0_Lzhndg?e=D0ccHb

- Plan Mobiliteti, sipas linkut:

https://unitiredu-my.sharepoint.com/:w:/g/personal/iro_unitir_edu_al/EfQ8VJyIfIRLp9JqRHse5BUBEqNwdpfrap2avNsZ5jv9Q?e=cCM65f

- Plan kërkimi për temën e diplomës;

- Kopje e pasaportës;

- Vërtetim studenti (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane);

- Listë notash doktore + master (të përkthyer në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze/italiane);

- Letër motivimi (në gjuhën angleze/italiane);

- Letër suporti nga një pedagog në Universitetin Ca'Foscari (mund të kontaktoni tek: international.cooperation@unive.it duke dërguar CV dhe planin e kërkimit);
- Certifikata e gjuhës së huaj, niveli B2 (Italisht/Anglisht).

Afati për aplikim: 22 Shtator 2020

Dokumentat duhen dorëzuar të skanuara në formatin PDF në adresën e-mail: iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!